

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. date _____ 2002

Nr. 56 date 18.03.2002

P Ë R FUNKSIONIMIN E SEKSIONEVE TE POLICISË GJYQËSORE

Mbështetur ne nenin 17 te Ligjit Nr.8677, date 02.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore".

UDHËZOJMË

1. Oficeret e policisë gjyqësore te Policisë Tatimore ne seksionin e prokurorisë kane për detyre kryesore te kryejnë veprime hetimore te plota e te gjithanshme kryesisht ose me urdhërim e delegim te prokurorit për zbulimin e autoreve dhe për sigurimin e provave për veprimtarinë e tyre, si dhe detyra te tjera te parashikuara ne Kodin e Procedurës Penale me qëllim zbatimin e Ligjit penal.
2. Oficeret e policisë gjyqësore te seksioneve nuk mund te ngarkohen me detyra qe nuk kane lidhje me veprimtarinë e policisë gjyqësore, qe janë caktuar ose deleguar nga prokurori kompetent, përveç rasteve te urgjencës. për te cilat është njoftuar dhe marre pëlqimi i drejtuesit te prokurorisë pranë se cilës funksionon seksioni i policisë gjyqësore.
3. Veprimtaria e oficerëve gjyqësore drejtohet dhe kontrollohet nga prokurori, sipas rregullave te përcaktuara ne Kodin e Procedurës Penale.
4. Oficeret e policisë gjyqësore te Policisë Tatimore do te qëndrojnë dhe kryejnë veprimet hetimore ne zyrat e prokurorisë. Pranë prokurorive te rretheve do te ketë zyra te veçanta ku do te punojnë oficeret e policisë gjyqësore. Dhe ne degët e tatimeve do te ketë zyra te veçanta ku oficeret e policisë gjyqësore mund te kryejnë veprime hetimore. Prokuroritë e rretheve detyrohen te pajisin me mjetet e punës (dosje, kancelari te tjera) oficerët e policisë gjyqësore pranë këtyre seksioneve. Organi Tatimor detyrohet te pajisin me mjetet e te punës qe i takojnë oficerëve te Policisë Tatimore.
5. Oficeret e policisë gjyqësore te Policisë Tatimore te seksionit te prokurorisë çdo dite fillimi pune do te paraqiten tek prokuroritë e rrethit qe i

ka ne varësi për te informuar për detyrat e kryera ne zbatim te urdhrave ose delegimeve si dhe për te marre detyra te tjera.

6. Për ngjarjet kriminale te ndodhura, veprimet e para hetimore, këqyrja e vendit te ngjarjes si dhe veprime te tjera te ngutshme si rregull do te kryhen nga oficeret e policisë gjyqësore te Policisë Tatimore qe ndodhen ne seksionet pranë prokurorisë. Menjëherë oficeri i policisë gjyqësore informon prokurorin për ngjarjen e ndodhur dhe veprimet e kryera, duke zbatuar dispozitat e Kodit te Procedurës Penale.

7. Ne rastet kur ngjarjet e ndodhura janë larg qendrave te seksioneve te policisë gjyqësore, veprimet e para te ngutshme, si këqyrja e vendit te ngjarjes, fiksimi dhe sekuestrimi i provave materiale, arrestimi ne flagrance i autoreve te veprës penale, kontrollet e banesave e tjera qe parashikohen ne kodin e procedurës penale, kryhen nga oficeret e policisë gjyqësore pranë shërbimeve te policisë gjyqësore te Policisë Tatimore.

8 Për ngjarjet kriminale qe ndodhin organet tatimore te marrin masat dhe te vene ne dispozicion mjetet për le shkuar grupi hetimor ne vendin e ngjarjes sa me shpejt. Prokuroritë e rretheve ne çdo muaj te përpilojnë listën e prokuroreve dhe oficerëve te policisë gjyqësore te seksioneve qe do te jene te gatshëm për ndjekjen dhe hetimin e çdo ngjarje kriminale. Kjo liste afishohet ne çdo prokurori dhe ne çdo rajon te policisë tatimore.


9 Fashikujt e procedimeve penale qe do te ndiqen nga oficeret e policisë gjyqësore te sektorëve te shërbimeve te policisë tatimore do jene te regjistruara ne regjistrin e procedimeve qe mban prokurori. Këto fashikuj do te merren me firme nga ana e oficerëve te policisë gjyqësore nga sekretaria e prokurorisë. Njëkohësisht dorëzimi i tyre do te behet me firme ne sekretarinë e prokurorisë.

Për njohjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohen strukturat e prokurorisë, seksionet e policisë gjyqësore, shërbimet e policisë gjyqësore te Policisë Tatimore te Ministrisë se Financave

Ky udhëzim hyn ne fuqi menjëherë

MINISTRI I FINANCAVE

KASTRIOT ISLAMI



PROKURORI I PERGJITHSHEM

ARBEN RAKIPT



